

508/5 prot



Dt. 26.12.2023

KËSHILLI I QARKUT DURRËS

VENDIM

Nr. 15 datë 26.12 2023

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit "Për buxhetin e vitit 2024", të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, Vendimit të Këshillit të Qarkut Nr.05, date.11.09.2023 "Mbi miratimin e dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 për Këshillin e Qarkut", VKM Nr.673 dt.02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publike", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Durrës.

V E N D O S

1. Të miratoje Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024 si më poshtë:

<i>Të ardhurat e Këshillit të Qarkut gjithsej</i>		<i>141'597'158 lekë</i>
Nga kjo	- Transferta e pakushtëzuar	47'953'986 lekë
	- Të ardhurat vendore	71.000.000 lekë
	- Të ardhurat të trashëguara	22'643'172 lekë
<i>Shpenzimet e Këshillit të Qarkut gjithsej</i>		<i>141'597'158 leke</i>
Nga kjo	Funksionet e veta nga granti:	
	- Për administratën e Këshillit të Qarkut	21'504'240 lekë
	- Për shpenz operative e vend gjyqësore	25'537'746 lekë
	- Për shpërblimin e antarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut	612'000 lekë
	- Për investime të prokuruar në 2023	300'000 lekë

Funksionet e veta nga të ardhurat dhe nga trashëgimia:

- Për investime në Këshillin e Qarkut 49'000'000 lekë
- Për shpenz operative e vend gjyqësore 41'000'000 lekë
- Për fondin rezervë 3'643'172 leke

2. Të miratoje nivelin e tarifave të shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut për komunitetin në funksion të realizimit të detyrave të tij mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi sipas pasqyrës bashkangjitur.
3. Të miratoje limitin e përdorimit të karburantit për automjetet e Këshillit të Qarkut deri në 400 litra në muaj, por brenda fondit limit për blerje karburanti të miratuar për vitin 2024.
4. Të miratojë limitin e përdorimit telefonisë celulare për vitin 2024 brenda mases 2% të shpenzimeve për mallra dhe shërbime si më poshtë:
 - Kryetar i Këshillit të Qarkut limiti mujor 4000 lekë
5. Të miratoje pasqyrat e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024, të cilat i bashkangjiten këtij vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria, Sektori i Financës, Burimet njerëzore, Sektori i Projekteve, DAMT dhe të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut dhe Dega e Thesarit Durrës.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 01 janar 2024.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ALFRED MULLARAJ

